

**VENDIM**  
**Nr.874, datë 14.12.2011**

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME  
KONCESION TË SHËRBIMIT TË MIRËMBAJTJES, REHABILITIMIT DHE OPERIMIT  
TË AUTOSTRADËS MILOT-MORINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1 dhe 3 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion të shërbimit të mirëmbajtjes dhe operimit të autostradës Milot-Morinë është Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

2. Koncesioni do të jetë i formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim në pronësi).

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**